



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-7731/21  
Kaçanik, 18.03.2021

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III-të (Tretë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 18 Mars 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtarja, Rabije Sallahi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Diana Reka dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Iliria Berisha, Lumbardh Malsiu, dhe dy zyrtarë tjerë të punësuar me kontratë në vepër.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfir Malsiu, Zyrtarë e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatojmë pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kuorumi ekziston, prezent në mbledhje janë 26 anëtarë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e III-të (Tretë) të Rregullt për vitin 2021, data 18 Mars, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Organogrami i Komunës së Kaçanikut;
3. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore; dhe
4. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse nuk ka kush diçka rreth rendit të punës, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

**Aprovoj**

**Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.**



U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;**

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua pa vërejtje me një Abstenim, atë të Selim Reka, për shkak se i njëjti nuk ka qenë pjesë e procesit. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës e,

**Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së II-të (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.02.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-2257/21.**

**Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Ekrem Kyçyku,** Faleminderit, përshëndetje për të gjithë,

Unë jam takuar me OJQ "Discovery Lab" që është e vendosur në shtëpinë e kulturës. Përfaqësuesit e kësaj shoqate me kanë thënë se e kanë pasur një marrëveshje bashkëpunimi me shtëpinë e kulturës dhe më komunë, për me i shfrytëzuar rreth 1000m<sup>2</sup> sipërfaqe, ndërkaq tani kjo hapësirë iu ka cenuar rreth 30 % nga OJQ "Shtëpia e Shpresës". Ata donë me ditur se kush e ka marrë atë vendim dhe pse është bërë kjo ?

**znj. Arlinda Rakoci-Raka,** Përshëndetje për të gjithë; Kam kërkesa dhe pyetje për DAK;

1. Bulizmi është prezentë në shkollat tona çdo ditë e më tepër. Unë jam e vetëdijshme që ky është problem global, por sa po bëjmë ne për të zvogëluar këtë dukuri? Aspak, sepse bulizmi po manifestohet edhe me dhunë fizike mes moshave të ndryshme. Rasti i fundit ishte në SHF "Emin Duraku", ku është vetëm një rast i bërë publik. Mendoj se ka edhe raste të tjera, por ato minimizohen ose fshehën brenda shkollave. Pyetja është; A organizohen ligjërata për këto grup moshë dhe a merret ndonjë masë ndëshkuese në harmoni me Ligjin për arsimin fillor ?

2. Kërkesa ime është: Të rritet numri i psikologëve në shkolla, dhe secili psikolog të kryen punën e vet, sepse ka raste të caktuar kur psikologu kryen punë administrative me shumë sesa merret me punët të cilat i përkasin.

3. Kërkesa tjetër është: Në shkolla të kenë së paktën një sociolog, sepse sociologët janë të nevojshëm në këtë kohë, ndërkaq po e shoh se në shkolla po parashihet të kenë pedagog, ndërkaq me e nevojshme është që shkollat me pasur sociolog sesa pedagog.

**z. Adnan Reka,** Përshëndetje për të gjithë kolegët,

1. Në mbledhjen e kaluar të KK e kam bërë një pyetje DUKMM, Drejtor! Unë nuk jam aspak i kënaqur me përgjigjen tuaj, por kjo nuk ka rendësi. Rëndësi ka pyetja,

E para, ne përgjigjen tuaj keni thënë: përgjigjes ju bashkëngjitën; kërkesa, fleta poseduese, kopja e planit, propozim-vendimi dhe vendimi i Kuvendit Komunal. Kjo është plotësisht e pa vërtetë sepse t'i këto dokumente po i sjell tani ne mbledhje, unë nuk kam kohë tani këtu t'i lexoj. Kjo nuk është në rregull, kur dihet fakti se në seancën e kaluar për këtë çështje debatua shumë.



E dyta, Përgjigjen që e ka dhënë DUKMM, aspak nuk ka të bëjë me atë që kam kërkuar. Unë thjeshtë e pyes drejtorin; Cili është interesi i komunës të shkëmbej sipërfaqen e rrugës së klasës të 4 me rrugën kryesore, dhe atë a di si! Të jepen 'kinse' disa qoshe të një parcele pa vlerë fare që askujt nuk i hyn në punë, për ta ngushtuar rrugën kryesore që është në shërbim të mijëra qytetarëve, kjo vërtetë është tmerr. Ta manipuloni kuvendin dhe të kërkonin nga kuvendi t'i jap pronat militantëve partiak edhe atë ku të duan, bile edhe në mes të rrugës, kjo me të vërtetë e tejkalon çdo normë.

Dhe e treta, Me thuaj a e ke ngushtuar rrugën kryesore, dhe me thuaj a e ke zgjeruar atë rrugën terciare, apo jo?

**2.** Kam edhe një pyetje tjetër të pa konfirmuar, pas shtëpisë së kulturës planifikoni të lëshoni një leje nderimi P+9, dhe të bëni ngushtimin e planifikuar të bulevardit Ismail Raka, për të realizuar interesat e ndërtuesve, cila është e vërteta e kësaj informate?

**znj. Hafize Sallahi,** Përhëndetje për të gjithë; Unë në mbledhjen e kaluar e kam bërë një pyetje Kryetarit të Komunës, ndërkaj nuk kam marrë ndonjë përgjigje.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Lidhur me pyetjen e znj. Sallahi theksoj se i kam përcjellë përgjigjet përmes Zyrës së KK, kështu që kontrolloini emalin, vetëm nëse është bërë ndonjë gabim, ajo është diçka tjetër.

**z. Zahir Doda- drejtor i DAK;** Përhëndetje për të gjithë; Lidhur me pyetjen të cilën e ngriti Ekrem Kyçyku, për OJQ "Diskoveri Lab" që është në shtëpinë e kulturës, ju njoftoj së; Nëse ajo OJQ iu ka ofruar ndonjë marrëveshje ose dokument për 1000m<sup>2</sup> me ndonjë miratim në emër timin, kisha dashur me mi ofruar të dhëna, se dje isha atje. Përveç një marrëveshje me drejtorin e shtëpisë së kulturës për shfrytëzim e hapësirës së Qendrës rinore që e kanë në menaxhim të drejtorit, asgjë tjetër nuk kanë. Prandaj, nuk ka asnjë cenim, të gjitha ato që janë të shkruar nga ajo OJQ janë të pavërteta, kam argument të plotë. Nëse vetëm një letër e kanë ose një dokument rreth kësaj, lë ta ofrojnë, unë jap përgjegjësi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pyetje dhe Kërkesa të tjera nuk ka, Para se me kaluar në pikën e radhës, e bëjë një: **Njoftim për çështjen e Deklarimit të pasurisë**

Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës harrova me bërë një njoftim të tillë. Afati për deklarim të pasurisë është deri me 31 Mars 2021. Besoj se iu ka ardhur edhe me email njoftimi, kështu që duhet të bëni deklarimin brenda afatit të përcaktuar, sepse në të kundërtën pasojë procedurat ligjore.

Atëherë konstatoj me kaluar në pikën e radhës të rendit të punës:

**2. Organogrami i Komunës së Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Organogrami është hartuar në bazë të Rregulloren për kompetencat, përgjegjësitë e organeve të administratës komunale. Fjalën e ka propozuesi, drejtori i DAP, Festim Neziraj;

**z. Festim Neziraj- drejtor i DAP,** I nderuari Kryesues, të nderuar anëtarë të asamblesë komunale, përshëndetje për të gjithë. Materialit ia kemi bashkangjitur shkresën më sqarime, kërkoj falje për këtë lëshim teknik që nuk ua kam dërguar më herët këtë shkresë, ndërkaj edhe në formë gojore do të jap sqarime të nevojshme.



Organogrami i Komunës është kryevepra e asaj që kemi nisur para dy viteve, me ndryshimin e Statutit të komunës dhe me aprovimin unanimit nga Kuvendi i Komunës të Rregulloren për kompetencat, përgjegjësitë e organeve të administratës komunale dhe na mbetet miratimi i këtij organogrami, cili ndër tjerash paraqet një strukturë organizative të komunës dhe administratës komunale - strukturë moderne mbi të cilat precizohet saktë kush kujt i përgjigjet dhe përgjegjësia e çdo sektori e çdo drejtorie për funksionimin e mirëfilltë të komunës. Ky është ai synimi ynë kryesor që kemi filluar para dy vitesh, por rrethanat kanë bërë që pikërisht në këtë kohë të vjen për miratim. Prandaj, për ti ikur keqkuptimeve, bëjë një sqarim; Ky organogram nuk shton vende të lira të punës, presim edhe katalogun e ministrisë për vende të lira të punës, por ende nuk ka dalë, prandaj mund të ketë disa ndryshime me pozitat e paraqitura. Në krye të organogramit janë qytetarët, ju jeni bartës të pushtetit, dhe gjithë se bashku synojmë që interesat e tyre t'i qojmë përpara. Sqarim shtesë, në f. 1, janë kodet nga 1 deri në 10, kodet janë si rezultat i intranetit. Çdo drejtori e ka kodin e vet, ndërkaq me 01 janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës, me 02 është Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, pastaj vazhdohet me drejtoritë tjera. Drejtoritë e reja do të bëhen funksionale me 1 janar 2022, është marrëveshje dhe në statut që drejtoritë e reja do të funksionalizime të veçanta nga ajo kohë. D.m.th. nga 1 janari 2022 do të janë funksionale 09 drejtori. Çdo pyetje shtesë apo koment, ne do të jemi në gjendje me iu përgjigjur.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Në mbledhjen e KPF ka pasur pyetje së a votohet ky organogram dhe sa është diferenca e të punësuarve? Sa punëtorë kanë qenë më herët dhe sa shtohet numri i tyre sipas këtij organogrami? Nëse votohet organogrami, ne subjekti politik i LVV do të votojmë kundër, sepse ky organogram është një derivat i dalë nga Statuti i Komunës dhe ne kemi qenë kundër kur u votua statuti i komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në bazë të informatave të cilat i mora nga ekzekutivi i komunës, komunat tjera e kanë votuar organogramin dhe do të votojmë edhe ne. Për pyetjen të cilën e ngrite z. Kyçyku, besoj së drejtori ka përgjigje.

**z. Festim Neziraj,** Me shifra të sakta nuk kam përgjigje, por e di se shtimi i numrit të punëtorëve nuk bëhet nga dëshirat apo tekeve që mund t'i kemi. Në administratë janë do rregulla që na përcaktojnë sesa punëtorë duhet me i pasur një drejtori apo një sektor, është buxheti dhe janë shumë aspekte tjera që e përcakton numrin e punëtorëve. Ne jemi duke e pritur ministrinë me na e përcjellë katalogun e vendeve të lira të punës sipas ligjit për zyrtarët publik, i cili katalog ende nuk ka ardhur dhe ne ende nuk mund të zhvillojmë procedura të konkursit të jashtëm, vetëm lëvizje horizontale dhe vertikale të stafit nga brenda

**z. Selim Reka,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Dokumenti i cili na ka ardhur në KPF nuk ka qenë i plotë, tani më veç është plotësuar dhe i njëjti i plotëson kushtet që të merr miratimin e tij.

**z. Ekrem Raka,** Faleminderit kryesues për sqarimet të cilat u dhanë. Unë kam qenë fuqishëm kundër shtimit të drejtorive, kështu që do të abstenoj kur kjo çështje të dal në votim, përndryshe nuk kam ndonjë vërejtje në organogramin e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Organogramin e Komunës e shtrojmë në votim për aprovim dhe i njëjti u miratua më shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarët



nga LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Me të cilin e Aprovoj Organogramin e Komunës së Kaçanikut / Lënda : 01Nr. 104/02-7837/21.**

**3. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Drejtori është prezent në mbledhje, i cili do të na jap sqarime tani apo pas përfundimit të diskutimeve. Fillimisht e hapi diskutimin për këtë pikë, pastaj nëse ka pyetje, drejtori iu përgjigjet.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka,** Unë nuk pajtohem me këtë emërim të komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore. Mendoj së ky komision duhet të jetë më i pavarur, e jo në përbërje të këtij komisioni të jetë një militante apo ndoshta anëtare e partisë së juaj me ndonjë vlerë. Do të thotë së, për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave duhet të jetë ndonjë anëtar tjetër i cili nuk është i përfshirë në politikë, sepse, jo çdo herë duhet të vendosë politika së kush duhet të jetë drejtor në institucione arsimore për të udhëhequr një drejtor që është meritore, sepse arsimi është një institucion që ka rëndësi të veçantë. Faleminderit.

**z. Ekrem Kycyku,** Edhe unë nuk do t'i përsërisë fjalët të cilat i kam thënë në KPF, por seriozisht po e themi së nëse hynë në facebookun e kandidates së propozuar për anëtare të komisionit, shihet së është militante e partisë, nuk ka asnjë shkrim për arsim edhe pse është drejtoreshë në arsim, por ka shkrime të saja kryekëput politike. Nëse kjo drejtoreshë zgjidhet në krye të një komisioni për emërimin e drejtorëve të shkollave, dihet se kënd ka me zgjedhur. Sa i përket arsytimit të drejtorit se duhet të jetë patjetër një drejtoreshë, unë e kam kuptuar së në këtë komision mund të jetë ndonjë zyrtar nga ndonjë institucion i pavarur arsimor, d.m.th janë tre mundësi për anëtarin e dytë të komisionit.

**z. Bekim Koxha,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Ne subjekti politik NISMA do të përkrahim këtë komision, ndërkaq ky komision duhet të jetë i sinqertë dhe t'i zgjedhë ata të cilët e meritojnë e jo të zgjidhet ata të cilët kanë elemente të ndryshme korruptive, elemente për sjellje jo të mira në shoqëri. Komisioni duhet të jetë i kujdesshëm dhe të zgjedhin më të mirin, nëse është e mundur.

**z. Ekrem Raka,** faleminderit kryesues; Unë pajtohem plotësisht me parafolësit e mijë. Ne jetojmë në Kaçanik dhe i dimë kandidatët me orientime politike. Ideja ime është që në këtë seancë të aprovohet vetëm propozimi për kandidatin e parë, Hajrush Dullovi, pasi që i plotëson të gjitha kushtet me qenë anëtar i komisionit, ndërsa për kandidatin me numër 2, Udhëzimi administrativ në të cilin është thirrur drejtori, të parin e liston me qenë anëtarë i komisionit, ekspert nga fusha e arsimit. Sipas mendimit tim, ekspert i arsimit mund të jetë çdo person që ka kryer fakultet të edukimit ose mësimdhënës i pensionuar. Iu sugjeroj që për mos me lënë shije të hidhur politike, sot të votojmë anëtarin, Hajrush Dullovi, ndërkaq në mbledhjen vijuese pozita të merret vesh me dy subjektet me të mëdha politike për kandidatin e dytë.

**z. Zahir Doda,** Unë shkurtimisht po përgjigjem; Propozimi për kandidatin e dytë, Mua gati më është imponuar kjo përzgjedhje, përndryshe nuk këmbënguli. Nëse edhe brenda KK keni



mundësi me zgjedhur ndonjë kandidat, e marrim parasysh. Eksperti i pavarur i arsimit, është vështirë për të gjetur. Ky Udhëzim Administrativ ka dalë para 2-3 muajve, emrat e propozuar nga DAK vetëm duhet të miratohen nga KK. Nuk formohet komisioni në KK, vetëm miratohen dy emra, ndërkaq komisionin pastaj e formon Kryetari i Komunës me emrat e rekomanduar nga KK dhe një emër i rekomanduar nga ministria, dhe 2 emra jemi të obliguar me i marrë si vëzhgues nga këshilli i shkollës dhe një vëzhgues nga këshilli i prindërve dhe formohet komisioni prej 5 anëtarëve. Ekspert i pavarur i arsimit, mua me kanë thënë nga ministria se nuk mundet çdo kush të jetë. Rinor Qehaja ishte ekspert i pavarur me certifikatë të arsimit, Dugagjin Popovci, edhe 2-3 emra tjerë që tani nuk po me kujtohen. Problemi është që edhe nëse i caktojmë ndonjërin nga këta ekspertë, vështirë së mund të vijmë, ky është problemi, ndërkaq në anën tjetër ta kontestojnë se është shkelje procedurale dhe ky është problemi, ekspertë në Kaçanik nuk ka. Opsioni i dytë sipas UA është: drejtorët e institucioneve arsimore. E treta, një përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e edukimit. Edhe me këto kritere nuk ka Komuna e Kaçanikut, këtu është problemi. Të DAK, propozimin nuk kam mundësi me lëvizur edhe ishte emër i pranueshëm, megjithatë mundet me pasur shkelje, nuk është bash krejt qysh duhet, por ka mundësi. E kemi në nivel të udhëheqjen, Arlinda Koxha- Elezi, është zëvendësdrejtore. Me sugjerim të ministrisë janë, që për përfaqësim gjinor, njëri anëtar me qenë femër, përndryshe nuk nguli këmbë lidhur me propozimin tim për anëtarin e dytë. Për mos me ngecur çështja, kërkoj mirëkuptimin tuaj që të kalojnë dy emrat e propozuar nga DAK. Unë e propozova edhe Arlinda Koxha- Elezi, zëvendësdrejtore në shkollën fillore “Emrin Duraku”, nëse kam mundësi me dhënë si propozim.

**z. Ekrem Kyqyku,** Kërkoj 5 minuta push për konsultim.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Po, ka mundësi për pushim 5 min. LVV për konsultim, ndërkaq pas 5 minutave vazhdoj punimet seanca aty ku kanë ngelur, duke ua dhënë fjalën sipas paraqitjes secilit anëtar të KK që kërkoj fjalën;

**z. Nexhat Loku,** Në emër të GP të PDK, konfirmoj së ne jemi për emrat e Propozuar si në Propozim Vendim. Nëse nuk kalojnë emrat e opropozuar, atëherë shkojmë me propozimin tjetër.

**z. Zahir Doda,** Të çështja e Arlinda Koxha-Elezi, Arlinda ka mundësi me na lënë procedurën në gjysmë, për shkak se e njëjta është e emëruar me kontratë, përndryshe unë kam biseduar me të. Arlinda mundet vetëm këtë procedurë me na e kryer se i skadon mandati i kontratës, ndërkaq dihet se ne kemi edhe zgjedhje tjera të drejtorëve, si drejtori i shkollës fillore “Emin Duraku” ka dhënë dorëheqja dhe ai vend duhet të shpallet. Për mos me dështuar ky konkurs, mundet Arlinda me qenë anëtare vetëm për këtë konkurs, ndërkaq unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që me kaluar propozimin që iu ka ardhur me material, për me shqyrtuar procedurën e konkursit, pasi që mund t’i kaloj afati konkursit nga dita e shpalljes se tij, shpallur që 6 javë, përndryshe nuk kam diçka tjetër. Për Arlindën iu tregova si është puna, e sqarova në detaje, ajo kërkon më së pari me u sistemuar në një vend pune, sepse ka mandat të zëvendësdrejtore, edhe nesër me u larguar, jetë pa punë, kështu që nuk ka ndonjë vend ajo të punësimi, sepse nuk ka qenë në sistem më përpara. Mendimi im është që me ndihmuar këtë proces, për mos me na dështuar ky konkurs, kërkoj të kalon miratimi i dy emrave të parë.

**z. Adnan Reka,** Desha me bërë një ndërhyrje të vogël të drejtorit i DAK; Me fal drejtor, por po insistoni për një emër që është folur e përfolur jashtëzakonisht shumë që askush nuk jemi pajtuar e as ju vet ndoshta nuk jeni pajtuar. Të gjitha manipulimet të cilat kanë ndodhur në



drejtorinë e Arsimit, është përgjegjës, ne e dimë, i ka punësuar krejt me rend, pikërisht prej këtyre pozitave. Ju po insistoni për një gjë të tillë, ajo është me pak së tepër e pranueshme kjo kërkesë.

**z. Selim Reka,** Unë kisha propozuar përsëri për faktin së po shihet se opozita është kundër propozimit të anëtarit të dytë si në Propozim Vendim. Unë kërkoj që të jetë propozim që doli për Arlinda Koxha- Elezi, aq sa e ka kontratën, të jetë në këtë komision, pastaj për konkurse tjera të gjendet ndonjë emër tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sido që të jetë, drejtori qëndron pran Propozim Vendimit të cilin e ka sjellë në KK, dhe sipas rregullit propozimi i parë del i pari në votim. Meqë dolën dy propozime, atëherë shkojmë më propozimin e parë, nëse nuk kalon i pari, atëherë shkojmë me propozimin e dytë. Propozim Vendimin e drejtorisë së Arsimit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 16 votë Për: (10 nga PDK, 2 nga NISMA, 2 nga LDK (Nazife Krasniqi dhe Besnik Salihu) dhe Hajredin Luta dhe Shemsedin Luzha,) 10 votë Kundër (7 nga LVV, 2 nga LDK (Selim Reka dhe Arlinda Rakoci-Raka) dhe Ekrem Raka nga IQ, ndërkaq votë Abstenim nuk ka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Me këtë Vendim, Aprovohet Propozim Vendimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës (DAK) për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;**

1. Hajrush Dullovi, Zyrtar i lartë i arsimit, Kryesues i komisionit;
  2. Florije Zeneli, Drejtoreshë në SHFMU "Idriz Seferi" Bob; Anëtare.
  3. Anëtar i tretë caktohet nga MASH.
- Lënda : 01 Nr. 01Nr. 104/02-7673/2021.**

4. Propozim Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Edhe të ky Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale i kemi dy anëtarë të cilët kanë ofruar dorëheqje, njëri është nga Kuvendi i Komunës, Adnan Reka nga LVV dhe tjetri nga Ekzekutivi, Bujar Dullovi. Propozim Vendimi i ekzekutivit të komunës është më u zëvendësuar këta dy anëtarë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Kërkoj nga LVV të jap një emër në zëvendësim të anëtarit, Adnan Reka.

**z. Adnan Reka,** Unë kërkoj që i gjithë komisioni të rizgjidhet, për shkak së ne nuk u pajtuam që krejt ky komision ka bërë shkelje. Në seancën e kaluar besoj së ne i cekëm shumë pika, ku ka bërë shkelje komisioni. Për mua nuk ka kuptim dhe anëtarët tjerë që mbesin në një komision që ka bërë shkelje që veç të bëhet plotësim ndryshim i vendimit, nuk e di sa është e arsyeshme kjo.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Neve na ka ardhur Propozim Vendimi nga drejtoria dhe të njëjtin e kemi proceduar për KK. A ka propozim nga LVV për anëtar të këtij komisioni nga ky subjekt politik ?

**z. Ekrem Kyçyku,** Nga LVV konfirmoj së nuk kemi ndonjë propozim për anëtar të këtij komisioni.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nga subjekti politik më i madh i grupit opozitar LDK, a keni ndonjë propozim ?

**z. Selim Reka**, Nga LDK konfirmoj së as ne nuk kemi ndonjë propozim për anëtar të komisionit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nga AAK, anëtari nuk është këtu, ndërkaq nga NISMA, a keni ndonjë propozim për anëtar të komisionit ?

**z. Bekim Koxha**, Në emër të NISMA, konfirmoj së nuk kemi propozim për anëtar të komisionit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, PDK është e përfaqësuar në këtë komision, ndërkaq nga subjektet politike në opozitë nuk ka ndonjë propozim për anëtar të komisionit vlerësues, atëherë e plotësojmë këtë komision vetëm me një anëtar nga ekzekutivi i komunës. Propozimin e shtroj në votim për aprovim për plotësim ndryshimin e komisionit vlerësues me vetëm me anëtarin Skënder Sopa, ndërkaq anëtari nga KK mbetet i pa plotësuar. Rezultati i votimit ishte, 15 votë Për, 7 votë kundër nga LVV Abstenuan 4 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Me të cilin Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i KK 01Nr. 60/01-36810/19 i datës 29.11.2019 dhe Vendimi 01Nr.104/02-3037/20 i datës 28.02.2020 që kanë të bëjnë me formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Ndryshim Plotësimet e Vendimit janë si vijon:

1. Nga komisioni vlerësues hiqet me kërkesën e tij anëtari i KK nga LVV Adnan Reka, ndërkaq nuk zëvendësohet me ndonjë anëtar tjetër.
2. Nga komisioni vlerësues hiqet më kërkesën e tij Bujar Dullovi –anëtar i komisionit nga ekzekutivi i komunës, dhe në vend të tij caktohet për anëtar të komisionit vlerësues nga Ekzekutivi i Komunës, Skënder Sopa.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:53. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK sa ishin edhe në fillim.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli

*Kemal Mërseli*



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);**

**nga Mbledhja e III-të (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 18.03.2021**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......